



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 95, Datë 09.05.2022

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBESP TRADING & CONSULTING” SH.P.K. PËR  
DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË  
KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 9, pika 2, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit, që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit, që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.05.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 608 prot., datë 27.04.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., me shkresën nr. 16 prot., datë 09.02.2022, protokolluar në ERE me nr. 257 prot., datë 11.02.2022, ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e kësaj shoqërie.
- Pas shqyrtimit paraprak të kërkesës dhe dokumentacionit të sjellë nga shoqëria, rezultoi se dokumentacioni nuk ishte i plotë, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresat e datës 23.02.2022 dhe në vijim me shkresën e datës 30.03.2022, duke i evidentuar dokumentacionin e paplotësuar apo të plotësuar pjesërisht.
- Në vijim, me shkresat e depozituara në ERE të datës 08.03.2022 dhe datës 13.04.2022, shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacion në kuadër të aplikimit të saj.
- Shoqëria duhet të plotësojë dokumentacionin që lidhet me kërkesat e nenit 7, pika 1, gërmat “e” dhe “f”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionerit,

që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit, që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 235, datë 26.11.2021, që kanë të bëjnë me përshkrimin e kandidatit të propozuar për të kontrolluar interesat e shoqërisë dhe dokumentimin e kontributit financiar të tij në ushtrimin e aktivitetit të licencuar.

- Për sa përcahtuar në nenin 9, pika 2, të Rregullores sipërcituar shoqëria duhet të depozitojë brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga marrja dijani e këtij vendimi dokumentacionin respektiv.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. të depozitojë në ERE dokumentacion plotësues në lidhje me përshkrimin e kandidatit të propozuar për të kontrolluar interesat e shoqërisë dhe kontributit financiar të tij në ushtrimin e aktivitetit të licencuar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**